



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi



REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE



Analizë e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë*

Kapitull nga 'Analizë e Mangësive të Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi'



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së
sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Mirënjohje

*Analiza e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë** është vetëm njëri kapitull nga një publikim më i gjerë i titulluar 'Analiza e Mangësive të Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi'. Analiza është bërë në një proces që ka përfshirë konsultim të gjerë dhe duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga përfaqësuesit e institucioneve publike. Sekretariati i IRK-së e shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e saj të sinqertë ndaj Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës*, e cila e ka dhënë një kontribut të vlefshëm në përpilimin e analizës së ligjit të Kosovës*.

Ky dokument është prodhuar si pjesë e projektit "Thyerja e heshtjes: Fuqizimi i Politikave dhe i Kulturës së Sinjalizimit në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi", që është financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti synon që t'i ndihmojë partnerët nga juridiksionet përfituese në përmirësimin e kanaleve raportuese të sinjalizimit dhe të mekanizmave mbrojtës; fuqizimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për mbështetjen e sinjalizuesve; dhe në ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut lidhur me rëndësinë e sinjalizimit në luftën kundër korrupsionit.

Autorët: Tom Devine dhe Mark Worth

Botuesi: Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit

Për botuesin: Desislava Gotskova – Udhëheqëse e Sekretariatit të IRK-së

Redaktore: Elmerina Ahmetaj Hrelja, Menaxhere e Projektit – Eksperte e Çështjeve Kundër Korrupsionit

Fra Andjela Zvizdovica 1, B/7, 71 000 Sarajevë
Bosnja dhe Hercegovina
Tel: +387 33 296 321; Fax: +387 33 296 329
e-mail: info@rai-see.org
Website: www.rai-see.org

SQARIM

Ky publikim është bërë me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe jo domosdoshmërisht i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Pikëpamjet e prezantuara në këtë publikim nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtarë të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit ose të shteteve të saj anëtare.

Dizajni dhe shtypi: UrbanGRAF

Gusht 2021

©RAI 2021. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret për qëllime jo komerciale, me mirënjohjen e duhur që i atribuohet IRK-së.

*Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe me Opinionin e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	7
Përmbledhje ekzekutive: Përparësitë dhe Dobësitë e Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi	9
Kosova*	11
Shtojca 1: Metodologjia e Analizës të Mangësive të Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi	23
Shtojca 2: Rekomandimi i Këshillit të Evropës	27
Shtojca 3: Të drejtat e fjalës së lirë në Direktivën e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Sinjalizuesve	31
Shtojca 4: Terminologjia	35



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së
sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

HYRJE

*Analiza e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë** është njëri kapitull nga një publikim më i gjerë i titulluar 'Analiza e Mangësive të Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi' botuar në Gjuhën Angleze nga Sekretariati i IRK-së në Gusht të vitit 2021, si pjesë e projektit të saj rajonal të financuar nga BE 'Thyerja e Heshtjes: Fuqizimi i Politikave dhe i Kulturës së Sinjalizimit në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi'.

Kapitulli *Analizë e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë** është ndarë nga analiza më e gjerë për qëllime të përkthimit në gjuhën shqipe dhe me një qëllim përfundimtarë të lehtësimit të procesit të përshtatjes dhe zbatimit të rekomandimeve të saj nga ana e autoriteteve kompetente. Ky kapitull i përfshinë pjesët vijuese të 'Analizës së Mangësive të Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi':

1. Përmbledhje ekzekutive: Përparësitë dhe Dobësitë e Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi;
2. Kapitulli mbi Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë*;
3. Metodologjia e Analizës (Shtojca 1);
4. Rekomandimi CM/Rec(2014)7 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (Shtojca 2);
5. Përmbledhje e Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) për Mbrojtjen e Personave të cilët i Raportojnë shkeljet e Ligjit të BE-së (Shtojca 3);
6. Terminologjia (Shtojca 4).

SQARIM: Ky është një përkthim jo zyrtarë në gjuhën shqipe; dhe për këtë arsye nuk mund të rezervohet asnjë e drejtë ligjore e bazuar në këtë dokument. Autorët nuk mund të mbahen përgjegjës për ndonjë përkthim të gabuar. Gjuha origjinale angleze e publikimit është gjuha mbizotëruese.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Përmbledhje ekzekutive: Përparësitë dhe Dobësitë e Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi

Si pjesë e projektit Thyerja e Heshtjes: *Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi*, është prodhuar kjo analizë e cila i krahason nëntë ligje për mbrojtjen e sinjalizuesve nga shtatë juridiksione me standardet e krijuara nga dy instrumentet kryesore që rregullojnë fushën e sinjalizimit në Evropë: Rekomandimi i Këshillit të Evropës i vitit 2014 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve¹ (në tekstin e mëtutjeshëm: Rekomandimi i KE-së) dhe Direktiva e Bashkimit Evropian (BE) për Mbrojtjen e Personave të cilët i Raportojnë Shkeljet e Ligjit të Bashkimit Evropian² (në tekstin e mëtutjeshëm: Direktiva e BE-së).

Shtatë juridiksionet, ligjet e të cilave janë analizuar dhe vlerësuar janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina³ (BH), Kosova*, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Për qëllim të këtij studimi, fillimisht është përgatitur një listë prej 21 standardeve kyçe që janë marrë nga Rekomandimi i KE-së dhe të Direktivës së BE-së, të cilat prezantojnë elementet themelore të mbrojtjes së sinjalizuesve (shih Shtojcën 1). Kjo analizë vlerëson nëse këto standarde janë të inkuorporuara në legjislacionin e secilit juridiksion dhe deri në çfarë mase. Analiza nuk e shqyrton ndikimin e ligjeve në sinjalizim. Përmes këtij vlerësimi janë identifikuar mangësitë eventuale dhe për secilin juridiksion janë bërë rekomandime për përmirësim.

Rezultatet e vlerësimit për secilin juridiksion janë prezantuar në seksione të ndara. Për secilin juridiksion, fillimisht është paraqitur lista e 21 standardeve të cilat shoqërohen me një analizë që vlerëson përputhshmërinë e ligjit me këto standarde. Nëse një standard është inkuorporuar në ligj ose mungon në mënyrë substanciale, një gjë e tillë përmendet në analizë. Nëse një standard është inkuorporuar pjesërisht ose është pasqyruar në mënyrë jo të duhur, atëherë ofrohet një shpjegim se cilat elemente mungojnë ose cilat janë pasqyruar në mënyrë jo të duhur. Në disa raste, janë shpjeguar ndikimet e mundshme që mund të kenë këto mangësi.

Në përfundimin e analizës së secilit juridiksion është përfshirë një vlerësim i përgjithshëm i ligjit përkatës i cili-1) tregon nëse ligji është në pajtueshmëri të plotë, të pjesërisht apo nuk është në pajtueshmëri me standardet europiane; dhe 2) ofron rekomandime se si të arrihet pajtueshmëria e plotë.

Qëllimi i kësaj analize është që t'u ndihmojë juridiksioneve në rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit të tyre për sinjalizimin në mënyrë që të jenë në pajtim me Direktivën e BE-së. Megjithatë, u takon juridiksioneve të vlerësojnë nëse ndryshimet janë të nevojshme ose të zbatojnë rekomandimet në një formë tjetër, dhe të përcaktojnë rendin e këtyre veprimeve. Zbatimi i rekomandimeve mund të përshtatet me rrethanat specifike të secilit juridiksion.

Gjatë analizës, janë bërë konsultime me agjencitë kundër korrupsionit dhe me institucionet tjera. Vlerësimi do të shërbejë si bazë për dialog, me qëllim të avokimit për shndërrimin e rekomandimeve në veprime, gjë që do të shpiente në mbrojtje më të mirë të sinjalizuesve.

¹ Rekomandimi CM/Rec(2014)7 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805c5ea5

² Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Tetor 2019 për mbrojtjen e personave të cilët i raportojnë shkeljet e ligjit të Unionit, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1937>

³ Për Bosnjën dhe Hercegovinën janë vlerësuar që të tre ligjet e tanishme të mbrojtjes së sinjalizuesve: Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Institucionet e Bosnjës dhe Hercegovinës, Ligji për Mbrojtjen e Personave të cilët i Raportojnë Korrupsionin në Distriktin e Bërkos dhe Ligji për Mbrojtjen e Personave të cilët i Raportojnë Korrupsionin në Republikën Srpska.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Të dhënat janë siguruar nga institucionet publike të juridiksioneve përfituese, të cilat kanë qenë të përfshira në analizë. Duke pasur parasysh rëndësinë e konsultimeve me palët e interesit, konsultimet me institucionet publike do të vazhdojnë në fazat e ardhshme të projektit.

Rezultatet e vlerësimit janë të prezantuara në mënyrë që ta lehtësojnë shqyrtimin e ndryshimeve potenciale ligjore, nëse një juridiksion vendos për diçka të tillë. Në përgjithësi, analiza ka gjetur se vetëm dy ligje për mbrojtjen e sinjalizuesve janë në pajtueshmëri të plotë me standardet europiane, përkatësisht Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë* dhe ai në Serbi. Katër ligje janë në pajtueshmëri të pjesërishtme me standardet europiane, përkatësisht ligjet e Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe të Entitetit të Republikës Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Tre ligje për mbrojtjen e sinjalizuesve nuk janë në pajtueshmëri me standardet europiane, përkatësisht ligji shtetëror i Bosnjës dhe Hercegovinës, ligji i Distriktit të Bërckos në BH dhe ligji i Moldavisë.

Fushat në të cilat ligjet e analizuar janë në pajtueshmëri me 21 standardet europiane janë:

- deklarimi i gjerë i të drejtave të sinjalizuesve;
- mbrojtja e gjerë e gjitha format e ngacmimit që mund të kenë "efekt frenues" në aftësinë dhe vullnetin e nëpunësve dhe qytetarëve për t'i raportuar sjelljet e pahijshme;
- kanalet e raportimit;
- personat e caktuar për pranimin dhe hetimin e sinjalizimeve dhe të ankesave për hakmarrje;
- garantimin e konfidencialitetit të sinjalizuesve.

Në përgjithësi, fushat në të cilat ligjet nuk i inkorporojnë në mënyrën e duhur 21 standardet, janë:

- mos përfshirja e standardit të "besimit të arsyeshëm" për raportimet;
- përfshirja e "mirëbesimit" ose të testeve të tjera të motivit të sinjalizuesve si një parakusht për mbrojtje;
- dështimi për ta mbrojtur lirinë e shprehjes publike (raportimet e bëra publike);
- dështimi për ta përfshirë barrën e provës tek punëdhënësit për të treguar se veprimet e ndërmarra ndaj nëpunësit nuk janë të ndërlidhura me sinjalizimin;
- fushëveprimi i papërshtatshëm i mbrojtjes për të gjithë sinjalizuesit e mundshëm me dëshmi të rëndësishme;
- mungesa e qartësisë dhe e qasjes për mbrojtje nga hakmarrja;
- ndihma jo e përshtatshme përmes mjeteve juridike;
- kufizimet në llojet e sjelljeve të pahijshme që mund të raportohen sipas ligjit;
- ndëshkimet e papërshtatshme për hakmarrje dhe veprime të tjera;
- dështimi në mbrojtjen ndaj ndjekjes civile dhe penale;
- standardet për kanalet e besueshme të raportimit të cilat ua mundësojnë sinjalizuesve ta përcjellin progresin e raporteve;
- mungesa e transparencës së zbatimit të ligjit.

Metodologjia e Analizës, e dakorduar me përfaqësuesit e institucioneve publike të juridiksioneve përfituese, është prezantuar në Shtojcën 1; Rekomandimi i Këshillit të Evropës është në Shtojcën 2; një përmbledhje e Direktivës së BE-së është në Shtojcën 3; dhe Terminologjia është në Shtojcën 4.

Kosova*

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (2018)

1) Ligji vlen për të gjithë nëpunësit dhe punëtorët e sektorit publik dhe privat, duke përfshirë kontraktorët, praktikantët, vullnetarët, punonjësit me gjysmë orari, punonjësit e përkohshëm, kandidatët për punësim, ish punonjësit si dhe anëtarët e organeve udhëheqëse.

Ligji përfshin punonjësit në sektorin publik dhe atë privat. Ata janë përkufizuar si njerëz të cilët e kanë pasur një "marrëdhënie pune me një institucion publik ose privat pa marrë parasysh natyrën e marrëdhënies së punës, kohëzgjatjen e saj ose pagesën." Këtu përfshihen bashkëpunëtorët e jashtëm ose të rastit, vullnetarët, praktikantët, të trajnuarit, kandidatët për punësim, kontraktorët dhe nënkontraktorët.

Ligji i mbron edhe personat që janë të lidhur me sinjalizuesin. Megjithatë, ende mbeten disa mangësi sa i përket personave që mbrohen. Ligji nuk i mbron në mënyrë eksplicite ata të cilët janë "gati" që të sinjalizojnë (të cilët janë duke bërë hulumtimin e nevojshëm për sinjalizim), ose ata të cilët (gabimisht) "dyshohen" që kanë sinjalizuar. Këto lëshime bëjnë që të mos mbrohen të gjitha kategoritë e njerëzve që janë të nevojshëm për sinjalizim efektiv.

Ndoshta mangësia më domethënëse në fushën e mbrojtjes së punonjësve është dështimi për ta mbrojtur në mënyrë eksplicite "raportimin në detyrë" – komunikimin e informacionit të mbrojtur përmes zinxhirit komandues të një organizate si pjesë e përgjegjësive të punës. Megjithatë, ky është konteksti më domethënës për komunikimin e informacionit të mbrojtur. Vetëm një përqindje e vogël e informacionit të mbrojtur sinjalizues komunikohet si si mospërputhje mendimesh. Secila organizatë ka nevojë për informacion të kompletuar dhe të saktë për gjykime dhe vendime të përgjegjshme dhe për kontrollat dhe balancat e tyre institucionale për të operuar në mënyrë efektive. Ky mangësi duhet larguar gjithashtu për ta siguruar pajtueshmërinë e ligjit me Direktivën e BE-së.

Lidhur me raportimin në detyrë, Neni 11 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve ofron mbrojtje gjithëpërfshirëse, pa ndonjë mangësi. Fushëverpimi i gjerë duhet sqaruar, ose përndryshe shumë punonjës mund të frikësohen që të komunikojnë informacione që ndërlidhen me sinjalizim si pjesë e detyrave të punës së tyre.

Rekomandim: Me shumë pak përmirësime të vogla, ligji do të jetë në pajtueshmëri të plotë. Përkufizimet duhen sqaruar në mënyrë që të mbrohen nga hakmarrja edhe personat të cilët perceptohen se janë gati për të sinjalizuar, ose që gabimisht perceptohen si sinjalizues. Ligji duhet që të shpjegohet për ta sqaruar se fusha e pakufizuar e Neni 11 për të gjitha raportet të cilat komunikojnë informacione të mbrojtura i përfshinë komunikimet formale dhe joformale në ndërlidhje me detyrat e punës, siç është raportimi i problemeve tek mbikëqyrësi dhe kur një raport është një përgjegjësi e punës.

2) Sinjalizimi e përfshinë korrupsionin; ryshfetin; cenimin e të drejtës publike; cenimin e të drejtave të njeriut; krimet financiare dhe mashtrimet; rreziqet ndaj konsumatorëve, shëndetin publik, sigurinë dhe mjedisin; dhe sjelljet tjera të paligjshme si dhe rreziqet të cilat e cenojnë ose e shqetësojnë interesin publik.

Ligji e përkufizon sinjalizimin si "raportim ose shpalosje e informacionit për veprimet ose mosveprimet të cilat e kërcënojnë ose cenojnë interesin publik." Këtu përfshihen veprimet ose mosveprimet të cilat kanë ndodhur, janë duke ndodhur ose që ka të ngjarë të ndodhin. Ligji thotë se nuk ekziston obligimi për të ofruar dëshmi dhe rregullorja e sapo miratuar e specifikon se sinjalizuesi nuk duhet që ta provojë besueshmërinë ose vërtetësinë e raportit. Raporti supozohet se është në interesin publik derisa nëse nuk vërtetohet e kundërta.

* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe me Opininionin e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Shkelja specifike përfshinë:

- mospërbushjen e ndonjë detyrimi ligjor;
- keqadministrimin e drejtësisë;
- rrezikimin e shëndetit apo sigurisë së ndonjë individi;
- dëmtimin e mjedisit;
- keqpërdorim e detyrës apo autoritetit zyrtar, parasë ose resurseve publike;
- veprimet diskriminuese, shtypëse ose të kryera nga pakujdesia ose keqmenaxhimi i rëndë nga një institucion publik.

Rekomandim: Ligji është në pajtueshmëri me këtë standard. Ligji duhet të sqarojë tutje se kategoritë e përfshira në ligj i përfshijnë të gjitha sjelljet e paligjshme specifike të renditura në Direktivën e BE-së dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës.

3) Për tu kualifikuar për mbrojtje, një person duhet të ketë besim, dyshim, ose bazë të arsyeshme për të besuar se informacioni i raportuar është i saktë. Sinjalizuesit nuk do t'i nënshtrohen testeve të "mirëbesimit" ose "motivit". Personi që raporton nuk duhet t'i kërkohet që ta provojë se ka ndodhur një shkelje dhe as nuk duhet të pritët që raportimi i tij të rezultojë në hetim, ndjekje penale ose ndonjë procedurë tjetër.

Ligji kërkon që sinjalizuesi të ketë "dyshim të arsyeshëm" se informacioni i raportuar është i vërtetë. Personi "nuk është i obliguar që ta provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë" e informacionit. Personi nuk e humb mbrojtjen nëse raportimi në fakt nuk e zbulon një cenim ose dëmtim të interesit publik. Ligji shprehimisht e ndalon shqyrtimin e motiveve të sinjalizuesit.

Rekomandim: Nuk nevojiten ndryshime. Ligji është në pajtueshmëri me këtë standard.

4) Mbrojtja s sinjalizesit nuk humbet për raportime të pasakta nëse personi ka gabuar pa qëllim të keq dhe me arsye ka besuar se informacioni është i saktë. Njerëzit që raportojnë supozohet se me arsye kanë besuar që informacioni është i saktë, përveç nese vërtetohet e kundërta.

Ligji i mbron të gjithë sinjalizuesit të cilët me arsye besojnë se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë dhe se sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar për të siguruar mbrojtjen. Sipas ligjit, "Mbrojtja e garantuar për sinjalizuesin sipas këtij ligji nuk duhet të paragjykohet nëse kërcënimi apo cenimi i supozuar i interesit publik nuk është materializuar". Për ta parandaluar hutimin dhe për t'i mbrojtur të gjithë njerëzit të cilët e bëjnë një raportim të bazuar në besimin e arsyeshëm, ligji duhet që ta thotë në mënyrë specifike se mbrojtja nuk humbet për sinjalizime të pasakta, të pakompletuara ose të gabuara që janë bërë në gabime të paqëllimta, të mbështetura në një besim të arsyeshëm. Terminologjia "mirëbesim" duhet që të hiqet nga ligji, edhe pse ligji nuk kërkon nga personi që ta provoj se ai ose ajo ka vepruar në mirëbesim. Kjo terminologji përdoret zakonisht për të provuar motivin e sinjalizuesit.

Rekomandim: Ligji është në pajtueshmëri me këtë standard. Mirëpo për ta parandaluar ndonjë konfuzion dhe për t'i mbrojtur të gjithë ata të cilët bëjnë raportime të mbështetura në besim të arsyeshëm, ligji duhet ta parasheh në mënyrë specifike se mbrojtja nuk humb për sinjalizime të pasakta, jo complete ose të gabuara të cilat janë bërë pa qëllim të keq dhe kanë qenë të mbështetura në besimin e arsyeshëm. Terminologjia "mirëbesim" duhet që të fshihet nga ligji, edhe pse ligji nuk kërkon nga personi që ta provoj se ai ose ajo ka vepruar në mirëbesim, për shkak se kjo terminologji përdoret zakonisht për të provuar motivin e sinjalizuesit.

5) Duhet të ekzistojnë kanale (procedura) të qarta të sinjalizimit, persona përgjegjës për të trajtuar sinjalizimet dhe procedura pasuese të qarta për të hetuar sinjalizimet si në vendet e punës në sektorin privat⁴ ashtu edhe në ato publik. Njerëzit kanë të drejtë që të zgjedhin sinjalizimin e brendshëm ose të jashtëm.

Sipas ligjit, punëdhënësit duhet t'u sigurojnë punonjësve udhëzime të shkruara lidhur me procedurat e sinjalizimit. Ato duhet të publikohen, përmisohen rregullisht dhe shpërndahen përshtatshëm në mjediset e punëdhënësit dhe në faqe të internetit kur është e mundur teknikisht.

Për raportimet e brendshme (brenda vendit të punës), ligji kërkon nga autoritetet publike me më shumë se 15 punonjës dhe nga entitetet private me më shumë se 50 punonjës, që ta caktojnë një "zyrtar përgjegjës" për regjistrimin, hetimin dhe shqyrtimin e raporteve.

Rregullorja për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimeve⁵ miratuar së fundmi ofron standarde të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse për zbatimin e kësaj kërkesë. Në përgjithësi, autoritetet në të cilat mund të bëhet sinjalizim i brendshëm apo i jashtëm kanë të drejtë në burime të mjaftueshme dhe personeli i tyre merr trajnime të detyrueshme rreth ligjit të sinjalizimit. Sipas rregullores, zyrtari përgjegjës bën hetime administrative, ka qasje në informacion dhe tek dëshmitarët dhe përgatitë raporte që ndërliken me veprimet korigjuese dhe rekomandimet disiplinore për udhëheqësin institucional. Përfundimisht, sipas rregullores, sinjalizuesi ka qasje në dosjen e rastit.

Rregullorja është gjithëpërfshirëse, e cila kërkon disa përmirësime modeste për ta arritur qëllimin e saj. Ndonëse rregullorja e nënkupton, nuk është e paraparë në mënyrë decisive që zyrtari përgjegjës të ketë pavarësi nga strukturat brenda institucionit. Edhe pse ekziston një dispozitë për burime të përshtatshme, duhet që të bëhen sqarime sipas të cilave zyrtari përgjegjës duhet ta ketë autoritetin që ta punësoj personelin e nevojshëm për hetimin dhe shqyrtimin e sjelljes së supozuar të paligjshme. Realisht, zyrtari përgjegjës nuk do të ketë burime ose ekspertizë të mjaftueshme për ta trajtuar i vetëm këtë mandat të gjerë.

Lëshimi i vetëm i rëndësishëm strukturor është mungesa e një dispozitë që rregullon konfliktin e interesit për zyrtarët përgjegjës.

Një punonjës mund ta anashkaloj zyrtarin përgjegjës dhe ta paraqes një raport tek menaxheri nëse:

- nuk ka zyrtarë përgjegjës;
- nuk ekzistojnë procedura të brendshme sinjalizuese;
- ekziston besimi i arsyeshëm se zyrtari përgjegjës mund të jetë i përfshirë ose i ndërlidhur me sjelljen e paligjshme; ose
- procedurat e brendshme të sinjalizimit mund të mos jenë efektive.

Për më tepër, sinjalizuesit nuk e kanë të drejtën e pakualifikuar që të zgjedhin në mes të kanaleve të brendshme dhe të jashtme. Për shpalosjet e jashtme, një person mund ta paraqes një raport fillimisht tek Agjencia Kundër Korrupsionit vetëm nëse:

- raporti ka të bëjë me menaxherin e punëdhënësit;
- sjellja e keqe ka "një karakter urgjent që është i ndërlidhur me një rrezik të rëndë ose të menjëhershëm ose me një dëm të pakthyesëm";
- punonjësi mund të pësoj hakmarrje;
- dëshmia mund të fshihet ose të shkatërrohet; ose
- procedurat e brendshme të sinjalizimit mund të mos jenë efektive.

⁴ Kompanitë mbi një prag të caktuar të numrit të personelit.

⁵ <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=41216>



Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Sistemi i sinjalizimit me dy nivele është i rëndë dhe krijon vonesa të qenësishme të veprimit ndaj sjelljes së paligjshme. Ai gjithashtu nuk është në përputhje me Direktivën e BE-së, e cila qartë e thotë se sinjalizuesit e kanë të drejtën e zgjedhjes së të raportuarit të brendshëm (tek punëdhënësi) ose të jashtëm (agjencitë qeveritare të zbatimit të ligjit). Ky ligj nuk është në pajtim me Direktivën e BE-së në këtë pikë. Duke i detyruar sinjalizuesit që të vendosin nëse informacioni i tyre mund të sinjalizohet brenda apo jashtë institucionet, mund të krijohet një efekt frenues tek ata.

Rekomandim: Ligji është në pajtueshmëri të plotë me pjesën e parë të këtij standardi. Ai duhet që të fuqizohet me një dispozitë e cila rregullon konfliktin e interesit të zyrtarëve përgjegjës; duhet të ofrohen burime të mjaftueshme për punën e Zyrtarit Përgjegjës; dhe pavarësi nga strukturat institucionale. Për të qenë në pajtueshmëri të plotë me Direktivën e BE-së, sinjalizuesit duhet ta kenë të drejtën absolute që lirshëm të zgjedhin në mes të sinjalizimit të brendshëm apo të jashtëm.

6) Njerëzit e kanë opsionin që të raportojnë publikisht (p.sh përmes mediave, OJQ-ve, takimeve publike, platformave online) në rrethana të arsyeshme të cilat nuk vendosin kufizime të panevojshme për personin ose të cilat kanë efekt frenues në publikimin e informacionit i cili kërkon hetim dhe veprime korrigjuese për mbrojtjen e interesit publik. Këto rrethana i përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:

- mosveprimin për më shumë se 6 muaj pas raportimit të brendshëm ose për 3 muaj pas shpalosjes së jashtme
- besimin e arsyeshëm për një konflikt interesi ose për shkatërrimin e dëshmive
- besimin e arsyeshëm për rrezikun e afërt ndaj shëndetit dhe sigurisë publike
- hakmarrjen që ka të ngjarë të ndodhë nëse përdoren kanalet institucionale.

Sipas ligjit, një punonjës do të mbrohet për shpalosje në publik nëse:

- ai ose ajo beson me arsye se ai ose ajo do të ndëshkohet për raportim të brendshëm ose tek autoritetet;
- ai ose ajo beson me arsye se dëshmia ka të ngjarë që të fshihet ose të shkatërrohet;
- ekziston kërcënimi i afërt për jetën, shëndetin publik, sigurinë dhe mjedisin;
- do të shkaktohet dëm i madh ose i pariparueshëm;
- zyrtarët përgjegjës dhe Agjencia Kundër Korrupsionit nuk kanë ndërmarrë asnjë “veprim përkatës” brenda gjashtë muajsh nga koha e paraqitjes së një raporti.

Për tu mbrojtur, ligji thotë se punonjësi i cili e bënë një raportim publik duhet “që ta respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë së të akuzuarit”, ta respektoj të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të mos e pengoj funksionimin e procedurave gjyqësore.

Edhe pse në përgjithësi ligji është në përputhje, sqarimi do të ishte i dobishëm. Përderisa ligji e zbaton testin e besimit të arsyeshëm në pjesën më të madhe të rrethanave, ekzistojnë përjashtime të rëndësishme. Edhe pse e ka për qëllim, ai nuk aplikohet në mënyrë të shprehur tek rreziqet e afërta ndaj shëndetit publik dhe sigurisë ose pronës dhe as tek dëmet e mëdha dhe të pariparueshme.

Rekomandim: Për të qenë në pajtueshmëri të plotë me Direktivën e BE-së, ligji duhet që ta përfshijë mbrojtjen për shpalosjen publike nëse një person e ka besimin e arsyeshëm se ekziston kërcënimi i afërt për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, ose se po shkaktohet një dëm i madh dhe i pariparueshëm.

7) *Sinjalizuesit kanë të drejtë në ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të tyre dhe të të gjitha informacioneve identifikuese, përveç kur hiqet dorë me pëlqimin e tyre paraprak ose nëse kjo gjë kërkohet nga hetimet zyrtare ose procedurat gjyqësore.*

Sinjalizuesit i gëzojnë të drejtat e praktikës më të mirë për mbrojtjen e identitetit të tyre. Zyrtarëve përgjegjës dhe të gjithë njerëzve tjerë të cilët i pranojnë ose i shqyrtojnë raportet u kërkohet që ta ruajnë fshehtësinë e informacionit të raportuar, dhe mund ta shpalosin ose transmetojnë informacionin tek palët vetëm me pëlqimin e sinjalizuesve me shkrim ose për ta përmbushur një detyrim ligjor lidhur me hetimin e shkeljeve; parandalimin e rrezikut të rëndë ndaj sigurisë, shëndetit publik, sigurisë publike ose mjedisit; parandalimin e krimet; ose ndjekjen e një vepre penale. Sinjalizuesit do të njoftohen para se të cenohet fshehtësia e tyre.

Rekomandim: Asnjë modifikim nuk është i nevojshëm. Ligji është në pajtueshmëri të plotë me këtë standard.

8) *Mbrojtjet dhe të drejtat shtrihen edhe tek sinjalizuesit anonimë të cilët më pas identifikohen - me ose pa pëlqimin e tyre.*

Ligji nuk e adreson mbrojtjen e sinjalizuesve anonimë në mënyrë specifike. Por kjo është një kërkesë minimale e ligjeve të mirapër mbrojtjen e sinjalizuesve. Sinjalizimet anonime mund t'i japin kahje të rëndësishme rasteve ose të përmbajnë dëshmi të vlefshme, shpesh në një vëllim më të madh se sa sinjalizimi i bërë përmes kanalevetjera. Njerëzit të cilët e paraqesin një sinjalizim anonim ose e bëjnë një shpalosje publike në mënyrë anonime duhet të mbrohen nëse ata më pas identifikohen dhe bëhen subjekt i hakmarrjes.

Rekomandim: Ligji duhet të modifikohet për ta ndjekur çdo dëshmi të besueshme që pranohet, qoftë në mënyrë anonime ose jo, dhe duhet t'i mbrojë sinjalizuesit anonim të cilët identifikohen.

9) *Sinjalizimet do të hetohen menjëherë dhe punonjësit do të informohen lidhur me hetimet dhe veprimet e ndërmarra në përgjigje të raportimeve të tyre brenda një periudhe të arsyeshme kohore.*

Ligji thotë se zyrtarët përgjegjës duhet që t'i bëjnë hetimet me nder, në mënyrë të paanshme, efikase, të fshehtë, duke e trajtuar sinjalizuesin në mënyrë të pavarur nga politikat ose ndikimet tjera dhe pa konflikte të interesit.

Ligji kërkon nga zyrtarët përgjegjës që t'i kryejnë hetimet në pajtim me procedurat ligjore. Hetimet e raporteve të brendshme duhet të përfundohen brenda 45 ditësh ose, sipas rregullores së miratuar rishtazi, brenda maksimumit prej 90 ditësh. Rregullorja poashtu gjithashtu kërkon që sinjalizuesi dhe keqbërësi i supozuar të njoftohen me rezultatet. Secilës palë të përfshirë në hetim i garantohet proces i rregullt, e drejta për të ofruar informacione, e drejta për ta konsultuar dosjen e hetimeve dhe të drejtën që t'i prezantojë pretendimet.

Sipas ligjit, institucionet duhet që të ndërmarrin masa të menjëhershme për t'i parandaluar ose ndaluar efektet e dëmshme të sjelljes së paligjshme të raportuar nga sinjalizuesi dhe duhet që t'i informojnë autoritetet nëse sjellja e paligjshme mund të përbëjë shkelje të ligjit.

Rekomandim: I fuqizuar me Rregulloren e miratuar rishtazi, ligji është në pajtueshmëri të plotë me këtë standard. Siç u diskutua më herët, ligji duhet që të ndryshohet në mënyrë që zyrtarët përgjegjës ta kenë autoritetin përkatës, pavarësinë nga struktura institucionale, kontrollimin e konflikteve të interesit si dhe qasjen në udhëheqësi.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

10) Sinjalizuesit do të mbrohen nga të gjitha format e hakmarrjes, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në shkarkimin, pezullimin, uljen në detyrë, transferimin ndëshkues, vlerësimin negativ të performancës ose referencës së punës, uljen e pagës, shqetësimin, listën e zezë dhe referimin psikiatrik ose mjekësor.

Ligji e përkufizon hakmarrjen si një "veprim ose mosveprim i cili e cenon interesin legjitim" të një punonjësi ose të ndonjë personi që ka lidhje me sinjalizuesin, ky i fundit është kushdo i cili e ndihmon sinjalizuesin ose ofron dëshmi lidhur me sinjalizimin. Ligji gjithashtu mbron edhe zyrtarët përgjegjës të cilët i pranojnë dhe i trajtojnë sinjalizimet.

Hakmarrja në mënyrë specifike e përfshin shkarkimin, pezullimin, transferimin, uljen në detyrë, uljen e pagës, humbjen e statusit dhe privilegjeve, mohimin e gradimit ose trajnimit, vlerësimin negativ të punës, anulimin e një licence ose leje, ndërprerjen e një kontrate për mallra ose shërbime, dhe përgjegjësinë civile ose kriminale.

Rekomandim: Nuk është i nevojshëm asnjë ndryshim. Ligji është në pajtueshmëri të plotë me këtë standard.

11) Barra e provës bie mbi punëdhënësin për të treguar se asnjë veprim i ndërmarrë kundër një punonjësi nuk ka qenë i ndërlidhur ose i motivuar nga fakti se punonjësi ka sinjalizuar, e ka konsideruar mundësinë e sinjalizimit ose e ka ndihmuar një person të sinjalizojë. Punonjësve nuk u kërkohet që ta provojnë lidhjen në mes të sinjalizimit dhe veprimeve të ndërmarra ndaj tyre.

Ligji thotë se punëdhënësit e kanë barrën që ta dëshmojnë se veprimi i dëmshëm i ndërmarrë ndaj ndonjë punonjësi nuk ka lidhje kauzale me personin i cili ka sinjalizuar. Edhe pse është në përputhje me tekstin e Direktivës së BE-së, pjesa narrative e sqaron tërë kontekstin për fushën e lidhjes kauzale. Me fjalë të tjera, nuk është e mjaftueshme për punëdhënësin që thjesht të tregoj se ekzistonte një arsye tjetër për veprimin e marrë kundër sinjalizuesit. Ndalimi i lidhjes kauzale me sinjalizimin vlen gjatë tërë procesit të sinjalizimit, jo thjesht për rezultatin përfundimtar. Siç e shpjegon Paragrafi 93 i Direktivës së BE:

'...sapo personi raportues ta demonstroj prima facie se ai ose ajo i ka raportuar shkeljet ose e ka bërë një shpallje publike në pajtim me këtë direktivë dhe si rezultat i saj e ka pësuar një dëm, barra e provës duhet të kalojë tek personi i cili e ka ndërmarrë veprimin e dëmshëm, nga i cili pastaj do të kërkohet që ta demonstroj se veprimi i ndërmarrë nuk ka pasur të bëjë në asnjë mënyrë me raportimin ose shpalljen publike'.

Punëdhënësi duhet ta dëshmojë bindshëm se çdo veprim i ndërmarrë ndaj një punonjësi nuk ka pasur fare të bëjë me sinjalizimin e tij.

Rekomandim: Ligji është në përputhje thelbësore me Direktivën e BE -së dhe synon ta sigurojë pajtueshmërinë e plotë. Për ta arritur atë rezultat, ai duhet ta sqarojë fushëveprimin e gjerë të lidhjes kauzale në mënyrë që sinjalizimi të mos jetë "i lidhur në asnjë mënyrë" me hakmarrjen e supozuar.

12) Nuk ka përgjegjësi civile, penale ose administrative për personat që sinjalizojnë në pajtim me ligjin.

Njerëzit të cilët sinjalizojnë në pajtim me ligjin "nuk mund të jenë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile ose t'i nënshtrohen procedurave disiplinore."

Rekomandim: Asnjë ndryshim nuk është i nevojshëm. Ligji është në pajtueshmëri të plotë me këtë standard.

13) Sinjalizuesit gëzojnë të drejtën në mbrojtje gjyqësore, gjykim të drejtë, prezumimit të pafajësisë, të drejtën për t'u mbrojtur, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për të pasur qasje në dosje.

Sipas ligjit, punonjësit të cilët kanë pësuar hakmarrje mund ta paraqesin një kërkesë për kompensim dhe "mbrojtje juridike" në gjykatën përkatëse. Shërbyesit civil duhet që t'i paraqesin kërkesat e tyre në Departamentin e Çështjeve Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Personi nuk ka nevojë që t'i "shteroj mjetet e brendshme juridike në procedurën administrative." Paditë ligjore duhet që të parashtrohen jo më vonë se tre vite pasi që ka ndodhur hakmarrja. Gjykatësit mund të urdhërojnë që sinjalizuesi i viktimizuar të rikthehet në vendin e tij/saj të punës ose të kompensohet për dëmet dhe mund ta urdhëroj punëdhënësin që të "ndërmarr veprime të caktuara". Rastet e sinjalizimit "do të trajtohen me prioritete nga ana e gjykatës."

Kjo pjesë e ligjit përmban dispozita të caktuara të cilat duhet shpjeguar, siç është "ndërmarrë veprime të caktuara" dhe "trajtohen me prioritet." Në përgjithësi, mekanizmat për mbrojtjen e urdhëruar nga gjykata janë në përputhje me praktikat më të mira të një procesi të rregullt, mirëpo këta mekanizma duhet që të sqarohen në mënyrë më të hollësishme në ligjin e sinjalizuesve. Për shembull në vet Ligjin e Sinjalizuesve, nuk ekziston asnjë kërkesë sipas së cilës kompensimi ose "veprimet e caktuara" janë të mjaftueshme për "shërimin e plotë" të sinjalizuesit, duke i neutralizuar të gjitha pasojat direkte dhe indirekte të sinjalizimit. Kjo do të thotë se sinjalizuesi ende mund të jetë "humbës duke fituar."

Kjo mbështetje është e specifikuar në ligjet e tjera civile, që do të thotë se në praktikë, ligji i Kosovës* është në përputhje të plotë me Direktivën e BE -së. Por teksti i ligjit nuk është i vetëmjaftueshëm për ta komunikuar tërë fushën e të drejtave të sinjalizuesve dhe ata ka të ngjarë që mos ta dinë se ku mund t'i gjejnë përfitimet shtesë të cilat nuk janë të listuara.

Rekomandim: Gama e plotë e të drejtave të cilat i ofron ligji është në pajtueshmëri të plotë me këtë standard. Sidoqoftë, kjo nuk do të bëjë shumë ndryshim nëse punonjësit nuk janë të vetëdijshëm për dispozitat ligjore të cilat nuk parashihen në ligjin e sinjalizuesve. Për ta komunikuar në mënyrë efektive sferën e plotë të përfitimeve të tyre, dispozitat ligjore që rregullojnë mjetet juridike duhet t'u ofrojnë autoriteteve të tjera njoftim se ato mundësojnë eliminimin e efekteve direkte dhe indirekte të hakmarrjes.

14) Të drejtat dhe mjetet juridike nuk mund të hiqen ose të kufizohen nga ndonjë marrëveshje ose kusht punësimi, përfshirë marrëveshjen e arbitrazhit para mosmarrëveshjes. Kontratat e punës nuk mund të përdoren për t'i parandaluar punonjësit që të bëjnë raportime ose që t'i diskutojnë ato.

Ligji parasheh që çdo dispozitë në një marrëveshje është e pavlefshme nëse synon që ta ndalojë ose kufizojë bërjen e një shpalosjeje publike, ndërhyjë në funksionimin e ligjit ose e përjashton një person nga ngritja e ndonjë procedure sipas ligjit. Edhe pse kjo është e mjaftueshme për një marrëveshjet konfidenciale, ajo nuk ofron mbrojtje kundër masave të sigurisë që mund të shqiptohen nga gjykatat.

Rekomandim: Ligji është në pajutshmëri të plotë me këtë standard. Duhet sqaruar se ai e anulon çdo politikë, urdhër ose kusht punësimi që bie ndesh me të drejtat e sinjalizuesit, duke përfshirë masat e sigurisë.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

15) Gjodat do të zbatohen për pengimin ose përpjekjen për ta penguar raportimin; hakmarrjen ose kërcënimin për hakmarrje ndaj një sinjalizuesi; inkurajimin ose faljen e hakmarrjes; ngritjen e procedurave ose veprimeve të pakëndshme kundër një sinjalizuesi; shkeljen e fshehtësisë së sinjalizuesit; dhe raportimin dhe/ose shpalosjen publike të informacionit të rremë me vetëdije.

Ligji thotë se çdo veprim ose mosveprim i cili e synon parandalimin e sinjalizimit mund të ndiqet penalisht. Gjykatat mund të shqiptojnë gjopa nga 500 deri në 20,000 € ndaj organizatave të sektorit publik ose privat, ose ndaj zyrtarëve përgjegjës për:

- dështimin për ta mbrojtur një sinjalizues nga dëmet;
- mos ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për tu dhënë fund dëmeve;
- mos njoftimi me shkrim i të gjithë punonjësve për të drejtat e tyre sipas ligjit;
- mos caktimin e një zyrtari përgjegjës;
- mos ndërmarrjen e veprimeve brenda afatit në përgjigje të një shpalosjeje;
- mos informimin e sinjalizuesit lidhur me rezultatin e një hetimi brenda afatit;
- mos informimin e sinjalizuesit lidhur me progresin dhe me veprimet e ndërmarra në rastin e tij ose saj;
- dështimin për t'i siguruar sinjalizuesit qasje në dosjet e çështjes ose për të marrë pjesë në çështje;
- përjashtimin e sinjalizimit;
- dështimin në ruajtjen e fshehtësisë së sinjalizuesit.

Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet në Gjykatën kompetente nga Agjencia kundër Korrupsionit për sektorin publik dhe Inspektorati i Punës për sektorin privat. Nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve institucionet përgjegjëse nuk ndërmarrin asnjë veprim apo refuzojnë të veprojnë atëherë sinjalizuesi mund të iniciojë vetë procedurën. Nëse personi përgjegjës është recidivistë, gjodat mund të dyfishohen.

Përveç Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Neni 388 i Kodit Penal e njeh hakmarrjen si vepër penale, përkatësisht: "Kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm ndaj çdo personi me qëllim të hakmarrjes për raportimin ose shpalosjen e informacionit për veprimet dhe mosveprimet që përbëjnë një kërcënim ose shkelje të interesit publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet."

Rekomandim: Ligji është në pajtueshmëri të plotë me këtë standard. Megjithatë, për shkak se vepra penale e hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është përfshirë në Kodin Penal, rekomandohet që Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve ta ketë një referencë lidhur me këtë mbrojtje shtesë, dhe që zyrtarët brenda Agjencisë Kundër Korrupsionit, zyrat e prokurorisë dhe institucionet e tjera të cilat e kanë një rol në sistemin e mbrojtjes së sinjalizuesve ta specifikojnë këtë të drejtë shtesë në edukimin, shpërndarjen dhe materialet e tyre të trajnimit.

16) Njerëzit e dëmtuar ose të prekur nga raportet të cilat dëshmojnë se janë të pasakta me vetëdije do të kenë qasje në mjetet juridike.

Ligji nuk e adreson në mënyrë specifike këtë çështje, mirëpo thotë se mbrojtja ligjore i përjashton sinjalizuesit të cilët bëjnë raporte të rreme me vetëdije.

Rekomandim: Asnjë rekomandim nuk është i nevojshëm, pasi ligji është në pajtueshmëri të plotë me këtë standard.

17) Një agjenci e caktuar do të promovojë sinjalizimin në mënyrë që të nxisë qëndrime pozitive publike ndaj sinjalizimit dhe ta lehtësojë raportimin.

Ligji nuk e adreson në mënyrë specifike këtë çështje, e cila është thelbësore në mënyrë që publiku të ndërgjegjësohet lidhur me të drejtat. Ligjet e sinjalizimit janë të fjetura ose shumë pak të përdorura, pjesërisht për shkak se publiku nuk ka njohuri për ekzistimin e tyre dhe pjesërisht për shkak se ato janë në kundërshtim me traditat e rrënjësura kulturore. Një fushatë ambicioze edukative publike është një parakusht që ligji t'i arrijë objektivat e tij.

Ekzistojnë programe të rëndësishme të trajnimit si kërkesë për punëdhënësit dhe shërbimin e Institutit të Kosovës* për Administratë Publike.

Rregullorja emiratuar rishtazi gjithashtu e parasheh detyrën e zyrtarit përgjegjës për veprime të cilat e lehtësojnë sinjalizimin dhe një web faqe për publikimin e rezultateve. Ndikimi i kësaj dispozite është shumë i rëndësishëm, megjithatë angazhimi duhet të jetë shumë më i madh se sa një artikull i shkurtër në një listë të gjatë të detyrave. Duhet sqaruar në tërësi së çfarë nënkupton kjo detyre.

Rekomandim: Ligji është në pajtushmëri thelbësore me këtë standard. Duhet të ekzistoj një garanci e financimit adekuat për autoritetin përgjegjës në mënyrë që ta udhëheq një fushatë të dedikuar publike edukative mbi natyrën e të drejtave të sinjalizuesve dhe mënyrën se si publiku mund të përfitojë nga ato.

18) Një agjenci e caktuar do të ofrojë ndihmë për shpалosjen e informacionit dhe mbrojtjen ndaj hakmarrjes përmes informacionit dhe këshillave falas lidhur me të drejtat, kanalet e raportimit, personat e kontaktit, procedurat, mjetet juridike dhe mbrojtjen ndaj hakmarrjes.

Rregullorja e re përcakton se zyrtari përgjegjës, ndër të tjera, do ta lehtësojë raportimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit përmes informacionit dhe këshillave falas lidhur me të drejtat e sinjalizuesve, kanalet e raportimit dhe mekanizmat e mbrojtjes nga hakmarrja.

Rekomandim: Për shkak të rregullores së re, ligji është në pajtushmëri të plotë me këtë standard.

19) Ndihma juridike është e disponueshme në procedurat e mbrojtjes ndaj hakmarrjes, në procedurat penale dhe procedurat civile ndërkufitare.

Ligji nuk e adreson në mënyrë specifike këtë çështje, e as procesin përmes të cilit do të llogariten dhe do të jipen tarifatat ligjore dhe kompensimet sinjalizuesve të cilët i fitojnë rastet e tyre. Kjo do të thotë se shumë sinjalizues të papunë nuk do të jenë në gjendje që t'i përballojnë tarifatat ligjore për të realizuar të drejtat e tyre ose të konsultohen me dikë të pavarur në mungesë të një agjencie të caktuar qeveritare.

Rekomandim: Ligji duhet ndryshuar për të ofruar ndihmë juridike dhe për mbulimin e tarifave të avokatit nga i pandehuri në procedurat kur sinjalizuesi e fiton rastin.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

20) Nje agjenci e caktuar do ta ofroj mbikëqyrjen e mekanizmave të shpalosjes së informacionit dhe mbrojtjes së sinjalizuesit; do t'i identifikoj dhe kërkoj korrigjimin e çdo mangësie dhe jo efikasiteti; si dhe do të mirëmbajë dhe publikoj çdo vit të dhëna anonime lidhur me numrin dhe llojin e raporteve sinjalizuese, kërkesave për mbrojtje nga hakmarrja dhe aprovimet, arsyet e mohimit të mbrojtjes nga hakmarrja dhe rezultatet e rasteve.

Institucionet publike, subjektet private dhe rregullatorët duhet ta përgatisin një raport vjetor dhe ta dorëzojnë atë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, e cila nga ana e saj duhet që gjithashtu ta përgatisë raportin e saj vjetor. Këto raporte duhet që ta përmbajnë numrin e shpalosjeve dhe veprimeve të ndërmarra si përgjigje.

Rekomandim: Direktiva e BE -së kërkon drejtpërdrejt vetëm raporte publike për numrin dhe rezultatet e shpalosjeve të sinjalizimit. Sidoqoftë, për të qenë në pajtushmëri të plotë me kërkesën e Direktivës së BE -së për rishikimin periodik të efektivitetit të ligjit në mbrojtjen e sinjalizuesve, është thelbësore që të përpiloni të dhëna shtesë për ta përmbushur këtë kriter. Kështu, dispozita e transparencës duhet që të zgjerohet për t'i përfshirë të dhënat lidhur me numrin e kërkesave dhe për mbrojtje nga hakmarrja si dhe të miratimeve, arsyet e mohimit të mbrojtjes nga hakmarrja dhe rezultatet e rasteve, si dhe një analizë të dobësive të saj bazuar në përvojën e deritanishme.

21) Do të bëhet një rishikim publik, transparent i ligjeve dhe politikave, dhe do të bëhen reformat e nevojshme, të paktën çdo tre vjet.

Ligji nuk e trajton në mënyrë specifike këtë çështje, megjithëse ekziston autoriteti për ta iniciuar rishikimin ex post facto të ligjit dhe për të bërë rekomandimet përkatëse. Sidoqoftë, parashikimi i qartë për rishikimin e detyrueshëm është thelbësor, sepse është joreale t'i përsosësh ligjet pa mësimet e nxjerra nga përvoja lidhur me zbatimin e tyre. Direktiva e BE-së kërkon nga autoritetet publike që çdo tre vjet t'i rishikojnë procedurat e tyre për pranimin dhe përcjelljen e progresit të raporteve, që ta marrin parasysh përvojën e tyre dhe t'i përshtatin procedurat e tyre në përputhje me rrethanat.

Rekomandim: Çdo tre vjet, Agjencisë Kundër Korrupsionit ose një agjencie tjetër të caktuar me ekspertizë përkatëse duhet t'i kërkohet që të raportojë mbi efektivitetin e ligjit në përmbushjen e objektivave të tij, dhe raporti duhet të përmbajë rekomandime specifike për përmirësimet e ligjit.

PËRMBLEDHJE

Kosova është në pajtushmëri të plotë thelbësore me standardet konsensuale europiane për të drejtat e sinjalizuesve. Ligji përmban një numër karakteristikash pozitive, duke përfshirë:

- obligimi që të gjitha institucionet dhe subjektet private të caktojnë zyrtarin përgjegjës për trajtimin e sinjalizimeve;
- fushveprim i gjerë i mbrojtjes kundër të gjitha formave të hakmarrjes në vendin e punës;
- mbrojtje për ata që ndihmojnë ose që ndërliqhen me sinjalizuesit;
- mbrojtje kundër hakmarrjes për zyrtarët përgjegjës që veprojnë sipas raportimit të sinjalizuesit;
- standardin e sinjalizimit bazuar në besim të arsyeshëm, pa kërkuar elementin e mirëbesimit;
- lirinë e shprehjes publike;
- mbrojtje kundër të gjitha formave të hakmarrjes në punë;
- mbrojtjengapërgjegjësiacivile ose penale;
- mbrojtje kundër marrëveshjeve të konfidencialitetit që do t'i minon të drejtat e garantuara me ligjin e sinjalizimit;
- qasjen në procese të rregullta gjyqësore;
- praktikat më të mira të mbrojtjes së fshehtësisë;
- vënien e barrës sëprovës të punëdhënësit;
- qasjen në mjetet juridike administrative dhe gjyqësore për të kërkuar ndihmë;
- të drejtën e sinjalizuesve për qasje në hetimin e raporteve të tyre;
- ndëshkimet disiplinore për mospërputhje;
- agjencinë përgjegjëse për promovimin e të drejtave të sinjalizuesve si dhe për tu ofruar udhëzime dhe ndihmë sinjalizuesve; dhe
- transparencën e historisë së ligjit.

Megjithatë, ligji nuk është plotësisht në pajtushmëri me standardet europiane konsensuale për shkak të lëshimeve, siq janë:

- mungesa e të drejtës se personave që të zgjedhin sinjalizimin e jashtëm ose publik pa u detyruar që fillimisht të përzgjedhin sinjalizimin e brendshëm;
- barra e kufizuar e provës tek punëdhënësi;
- mungesa e dispozitave ligjore mbrojtëse edhe për sinjalizuesit anonimë të cilët më pas identifikohen - me ose pa pëlqimin e tyre;
- dështimi për të ofruar ndihmë juridike ose për t'i mbuluar tarifat e avokatit për shumicën e sinjalizuesve; dhe
- mungesa e një rishikimi të detyrueshëm periodik të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Shtojca 1: Metodologjia e Analizës të Mangësive të Ligjeve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Ballkanin Perëndimorë dhe në Moldavi

Që nga viti 2013, në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Moldavi, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi janë miratuar ligje të caktuara për mbrojtjen e sinjalizuesve ose dispozita statutore. Në pajtim me këto ligje dhe dispozita, punonjësit në të gjitha këto juridiksione kanë raportuar krime, raste të korrupsionit, kërcënime ndaj shëndetit publik ose shqetësime të tjera tek mbikëqyrësit e tyre, autoritetet publike, OJQ -të, mediat dhe tek publiku i gjerë.

Analiza e e bënë krahasimin e ligjeve të shtatë juridiksioneve⁶ me rekomandimin e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (në tekstin e mëtutjeshëm Rekomandimi i KE-së) dhe me Direktivën e BE-së për Mbrojtjen e Personave të cilët i Raportojnë Shkeljet e Ligjit të Unionit (në tekstin e mëtutjeshëm Direktiva e BE-së). Për këtë qëllim, nga Rekomandimi i KE-së dhe Direktiva e BE janë nxjerrë njëzet e një standardet kryesore. Analiza vlerëson se deri në çfarë mase secili standard është i përfshirë në këto ligje. Përmes këtij vlerësimi sasior, janë identifikuar e mangësitë e përgjithshme dhe të veçanta në dispozitat statutore, dhe për secilin juridiksion janë bërë rekomandimet për përmirësim.

Rezultatet e Analizës dhe rekomandimet do ta sigurojnë bazën për avokimin pasues, ngritjen e kapaciteteve dhe për aktivitetet e ndërgjegjësimit publik me qëllim të përmirësimit të politikave dhe sistemeve të sinjalizuesve në të shtatë juridiksionet. Këto aktivitete do ta përfshijnë prezantimin e rezultateve dhe materialeve përkatëse përmes Sekretariatit të IRK-së dhe ngjarjeve të tjera, trajnimeve me shumë palë të interesit, misioneve për ngritjen e kapaciteteve, platformën e mësimin të Sekretariatit të IRK-së, fushatat e edukimit të qytetarëve dhe pjesëmarrjen e OJQ-ve.

Standardet kyçe për krahasim:

- 1) Ligji vlen për të gjithë nëpunësit dhe punëtorët e sektorit publik dhe privat, duke përfshirë kontraktorët, praktikantët, vullnetarët, punonjësit me gjysmë orari, punonjësit e përkohshëm, kandidatët për punësim, ish punonjësit si dhe anëtarët e organeve udhëheqëse.
- 2) Sinjalizimi e përfshinë korrupsionin; ryshfetin; cenimin e të drejtës publike; cenimin e të drejtave të njeriut; krimet financiare dhe mashtrimet; rreziqet ndaj konsumatorëve, shëndetin publik, sigurinë dhe mjedisin; dhe sjelljet tjera të paligjshme si dhe rreziqet të cilat e cenojnë ose e shqetësojnë interesin publik.
- 3) Për tu kualifikuar për mbrojtje, një person duhet të ketë besim, dyshim, ose bazë të arsyeshme për të besuar se informacioni i raportuar është i saktë. Sinjalizuesit nuk do t'i nënshtrohen testeve të "mirëbesimit" ose "motivit". Personi që raporton nuk duhet t'i kërkohet që ta provojë se ka ndodhur një shkelje dhe as nuk duhet të pritët që raportimi i tij të rezultojnë hetim, ndjekje penale ose ndonjë procedurë tjetër.
- 4) Mbrojtja s sinjalizuesit nuk humbet për raportime të pasakta nëse personi ka gabuar pa qëllim të keq dhe me arsye ka besuar se informacioni është i saktë. Njerëzit që raportojnë supozohet se me arsye kanë besuar që informacioni është i saktë, përveç nese vërtetohet e kundërta.

⁶ Për Bosnjë-Hercegovinën, ligjet në nivel entiteti do të përfshihen.



Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

- 5) Duhet të ekzistojnë kanale (procedura) të qarta të sinjalizimit, persona përgjegjës për të trajtuar sinjalizimet dhe procedura pasuese të qarta për të hetuar sinjalizimet si në vendet e punës në sektorin privat⁷ ashtu edhe në ato publik. Njerëzit kanë të drejtë që të zgjedhin sinjalizimin e brendshëm ose të jashtëm.
- 6) Njerëzit e kanë opsionin që të raportojnë publikisht (p.sh përmes mediave, OJQ-ve, takimeve publike, platformave online) në rrethana të arsyeshme të cilat nuk vendosin kufizime të panevojshme për personin ose të cilat kanë efekt frenues në publikimin e informacionit i cili kërkon hetim dhe veprime korigjuese për mbrojtjen e interesit publik. Këto rrethana i përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:
 - mosveprimin për më shumë se 6 muaj pas raportimit të brendshëm ose për 3 muaj pas shpalosjes së jashtme
 - besimin e arsyeshëm për një konflikt interesi ose për shkatërrimin e dëshmive
 - besimin e arsyeshëm për rrezikun e afërt ndaj shëndetit dhe sigurisë publike
 - hakmarrjen që ka të ngjarë të ndodhë nëse përdoren kanalet institucionale.
- 7) Sinjalizuesit kanë të drejtë në ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të tyre dhe të të gjitha informacioneve identifikuese, përveç kur hiqet dorë me pëlqimin e tyre paraprak ose nëse kjo gjë kërkohet nga hetimet zyrtare ose procedurat gjyqësore.
- 8) Mbrojtjet dhe të drejtat shtrihen edhe tek sinjalizuesit anonimë të cilët më pas identifikohen - me ose pa pëlqimin e tyre.
- 9) Sinjalizimet do të hetohen menjëherë dhe punonjësit do të informohen lidhur me hetimet dhe veprimet e ndërmarra në përgjigje të raportimeve të tyre brenda një periudhe të arsyeshme kohore.
- 10) Sinjalizuesit do të mbrohen nga të gjitha format e hakmarrjes, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në shkarkimin, pezullimin, uljen në detyrë, transferimin ndëshkues, vlerësimin negativ të performancës ose referencës së punës, uljen e pagës, shqetësimin, listën e zezë dhe referimin psikiatrik ose mjekësor.
- 11) Barra e provës bie mbi punëdhënësin për të treguar se asnjë veprim i ndërmarrë kundër një punonjësi nuk ka qenë i ndërlidhur ose i motivuar nga fakti se punonjësi ka sinjalizuar, e ka konsideruar mundësinë e sinjalizimit ose e ka ndihmuar një person të sinjalizojë. Punonjësve nuk u kërkohet që ta provojnë lidhjen në mes të sinjalizimit dhe veprimeve të ndërmarra ndaj tyre.
- 12) Nuk ka përgjegjësi civile, penale ose administrative për personat që sinjalizojnë në pajtim me ligjin.
- 13) Sinjalizuesit gëzojnë të drejtën në mbrojtje gjyqësore, gjykim të drejtë, prezumimit të pafajësisë, të drejtën për t'u mbrojtur, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për të pasur qasje në dosje.
- 14) Të drejtat dhe mjetet juridike nuk mund të hiqen ose të kufizohen nga ndonjë marrëveshje ose kusht punësimi, përfshirë marrëveshjen e arbitrazhit para mosmarrëveshjes. Kontratat e punës nuk mund të përdoren për t'i parandaluar punonjësit që të bëjnë raportime ose që t'i diskutojnë ato.

⁷ Kompanitë mbi një prag të caktuar të numrit të personelit.

- 15) Gjobat do të zbatohen për pengimin ose përpjekjen për ta penguar raportimin; hakmarrjen ose kërcënimin për hakmarrje ndaj një sinjalizuesi; inkurajimin ose faljen e hakmarrjes; ngritjen e procedurave ose veprimeve të pakëndshme kundër një sinjalizuesi; shkeljen e fshehtësisë së sinjalizuesit; dhe raportimin dhe/ose shpalsjen publike të informacionit të rremë me vetëdije.
- 16) Njerëzit e dëmtuar ose të prekur nga raportet të cilat dëshmojnë se janë të pasakta me vetëdije do të kenë qasje në mjetet juridike.
- 17) Një agjenci e caktuar do të promovojë sinjalizimin në mënyrë që të nxisë qëndrime pozitive publike ndaj sinjalizimit dhe ta lehtësojë raportimin.
- 18) Një agjenci e caktuar do të ofrojë ndihmë për shpalsjen e informacionit dhe mbrojtjen ndaj hakmarrjes përmes informacionit dhe këshillave falas lidhur me të drejtat, kanalet e raportimit, personat e kontaktit, procedurat, mjetet juridike dhe mbrojtjen ndaj hakmarrjes.
- 19) Ndihma juridike është e disponueshme në procedurat e mbrojtjes ndaj hakmarrjes, procedurat penale dhe procedurat civile ndërkufitare.
- 20) Një agjenci e caktuar do ta ofrojë mbikëqyrjen e mekanizmave të shpalsjes së informacionit dhe mbrojtjes së sinjalizuesit; do t'i identifikoj dhe kërkoj korrigjimin e çdo mangësie dhe jo efikasiteti; si dhe do të mirëmbajë dhe publikoj çdo vit të dhëna anonime lidhur me numrin dhe llojin e raporteve sinjalizuese, kërkesave për mbrojtje nga hakmarrja dhe aprovimet, arsyet e mohimit të mbrojtjes nga hakmarrja dhe rezultatet e rasteve.
- 21) Do të bëhet një rishikim publik, transparent i ligjeve dhe i politikave dhe do të bëhen reformat e nevojshme, të paktën çdo tre vjet.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Shtojca 2: Rekomandimi i Këshillit të Evropës

Rekomandimi [CM/Rec\(2014\)7](#) i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave me datën 30 Prill 2014, në takimin e 1198-të të Zëvendës Deputetëve të Ministrave)

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të parapara në Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke kujtuar se qëllimi i Këshillit të Evropës është që ta arrijë një unitet më të madh midis anëtarëve të tij, *ndër të tjera*, me qëllim të ruajtjes dhe realizimit të idealeve dhe parimeve të cilat janë trashëgimia e tyre e përbashkët;

Duke pas parasysh që promovimi i miratimit të rregullave të përbashkëta në çështjet juridike mund të kontribuojë në arritjen e qëllimit të lartpërmendur;

Duke ripohuar se liria e shprehjes dhe e drejta për të kërkuar dhe për të marrë informacione janë themelore për funksionimin e një demokracie të mirëfilltë;

Duke pranuar faktin që individët ("sinjalizuesit") të cilët raportojnë ose zbulojnë informacione mbi cenimet ose dëmtimet e interesit publik mund të kontribuojnë në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies demokratike;

Duke marrë parasysh që trajtimi i duhur nga punëdhënësit dhe autoritetet publike i shpalosjes së informacioneve të interesit publik do ta lehtësojë marrjen e veprimeve për korrigjimin e kërcënimeve ose dëmtimeve të ekspozuara;

Duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ETS Nr. 5) dhe praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, veçanërisht në lidhje me Nenin 8 (respektimi i jetës private) dhe Nenin 10 (liria e shprehjes), si dhe Konventën për mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS Nr. 108);

Duke pasur parasysh Programin e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Korrupsionit, Konventën e Këshillit të Evropës për të Drejtën Penale mbi Korrupsionin (ETS Nr. 173) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për të Drejtën Civile mbi Korrupsionin (ETS Nr. 174) dhe, në veçanti, respektivisht Nenet 22 dhe 9 të tij, si dhe punën e kryer nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO);

Duke marrë parasysh Rezolutën 1729 (2010) të Asamblesë Parlamentare në të cilën Asambleja i fton Shtetet Anëtare që ta rishikojnë legjislacionin e tyre në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesve duke pasur parasysh një sërë parimesh udhëzuese;

Duke marrë parasysh përmbledhjen e praktikave më të mira dhe parimet udhëzuese për legjislacionin mbi mbrojtjen e sinjalizuesve të përgatitur nga OECD me kërkesë të udhëheqësve të G20-shes në Samitin e tyre në Seul në Nëntor 2010;

Duke pasur parasysh ekzistencën e nevojës për ta inkurajuar miratimin e kornizave kombëtare në Shtetet Anëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve bazuar në një sërë parimesh të përbashkëta



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Rekomandon që shtetet anëtare ta kenë një kuadër normativ, institucional dhe gjyqësor për t'i mbrojtur individët të cilët, në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të bazuara në punë, raportojnë ose shpalosin informacione mbi kërcënimet ose dëmtimet e interesit publik. Për këtë qëllim, shtojca e këtij rekomandimi e përcakton një sërë parimesh për t'i udhëzuar shtetet anëtare me rastin e rishikimit të ligjeve të tyre kombëtare ose kur e prezantojnë legjislacionin dhe rregulloret ose me rastin e bërjes së ndryshimeve sipas nevojës dhe kurdo që është e përshtatshme në kontekstin e sistemeve të tyre ligjore.

Për aq sa marrëdhëniet e punës rregullohen nga marrëveshjet kolektive të punës, shtetet anëtare mund t'i japin efekt këtij rekomandimi dhe parimeve të përfshira në shtojcë në kuadrin e marrëveshjeve të tilla.

PARIMET

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij rekomandimi dhe parimeve të tij:

- a. "sinjalizues" nënkupton çdo person që raporton ose shpalos informacione mbi një kërcënim ose dëmtim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së tyre të bazuar në punë, qoftë në sektorin publik apo privat;
- b. "raportimi ose shpalosja e informacionit me interes publike" e nënkupton raportimin ose shpalosjen e informacionit mbi veprimet dhe mosveprimet të cilat paraqesin kërcënim ose dëmtim për interesin publik;
- c. "raport" do të thotë raportim qoftë brenda një organizate ose ndërmarrje qoftë tek një autoritet i jashtëm;
- d. "shpalosje" e nënkupton bërjen publike të një informacioni.

I. Fushëveprimi material

1. Duhet të hartohet dhe të zhvillohet korniza kombëtare normative, institucionale dhe gjyqësore, duke përfshirë, sipas nevojës, marrëveshjet kolektive të punës, për t'i lehtësuar raportet dhe shpalosjet e informacioneve me interes publik duke vendosur rregulla për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të sinjalizuesve.
2. Për qëllimet e zbatimit të këtyre parimeve, u takon Shteteve Anëtare që ta përcaktojnë se çfarë qëndron në interesin publik. Shtetet Anëtare duhet që ta specifikojnë në mënyrë eksplicite fushëveprimin e kornizës kombëtare, e cila, të paktën, duhet që t'i përfshijë shkeljet e ligjit dhe të drejtat e njeriut, si dhe rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë publike dhe mjedisit.

II. Fushëveprimi personal

3. Fushëveprimi personal i kornizës kombëtare duhet që t'i mbulojë të gjithë individët që punojnë qoftë në sektorin publik qoftë në atë privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës së tyre dhe nëse ata paguhen ose jo.
4. Korniza kombëtare duhet që t'i përfshijë gjithashtu individët, marrëdhënia e punës së të cilëve ka përfunduar dhe, mundësisht, kur marrëdhënia e punës ende nuk ka filluar në rastet kur informacioni në lidhje me një cenim ose dëmtim të interesit publik është marrë gjatë procesit të rekrutimit ose paraprakisht gjatë fazës së negociatave kontraktuale.
5. Për informacionet që lidhen me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën, rendin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit mund të zbatohet një skemë ose rregulla speciale, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e modifikuara.
6. Këto parime nuk i cenojnë rregullat e mirë vendosura dhe të pranura për mbrojtjen e privilegjeve ligjore dhe privilegjeve tjera profesionale.

III. Korniza normative

7. Korniza normative duhet që ta pasqyrojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe koherente për ta lehtësuar raportimin dhe shpalosjen e informacionit të interesit publik.
8. Kufizimet dhe përjashtimet e të drejtave dhe detyrimeve të çdo personi në lidhje me raportet dhe shpalosjet e informacionit me interes publik nuk duhet të jenë më shumë se të nevojshme dhe, në çdo rast, të mos jenë të tilla që t'i imponojnë objektivat e parimeve të përcaktuara në këtë rekomandim.
9. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen se ekziston një mekanizëm ose mekanizma efektiv për të vepruar ndaj raporteve dhe shpalosjeve të informacionit me interes publik.
10. Secili person i cili paragjykohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga raportimi ose shpalosja e informacionit të pasaktë ose mashtrues, sipas rregullave të ligjit të përgjithshëm duhet që ta ketë në dispozicion të tij ose saj të drejtën për mbrojtje dhe mjete juridike.
11. Një punëdhënës nuk duhet të jetë në gjendje që të mbështetet në detyrimet ligjore ose kontraktuale të një personi në mënyrë që ta parandalojë atë person nga bërja e një raporti ose nga shpalosja e informacionit me interes publik apo për ta ndëshkuar atë për një gjë të tillë.

IV. Kanalet e raportimit dhe shpalosjes së informacionit

12. Korniza kombëtare duhet që ta nxisë një mjedis i cili e inkurajon raportimin ose shpalosjen e informacionit në mënyrë të hapur. Individët duhet të ndihen të sigurt për t'i ngritur lirshëm shqetësimet e interesit publik.
13. Duhet të krijohen kanale të qarta për raportimin dhe shpalosjen e informacioneve me interes publik dhe atyre duhet siguruar burime përmes masave të përshtatshme.
14. Kanalet për raportim dhe shpalosje të informacionit i përfshijnë:
 - raportet brenda një organizate ose ndërmarrje (përfshirë personat e caktuar për t'i pranuar raportet në fshehtësi;
 - raportet tek organet përkatëse rregullatore publike, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe organet mbikëqyrëse;
 - shpalosjet e informacionit për publikun, për shembull për një gazetar ose një anëtar të parlamentit (deputet).

Rrethanat individuale të secilit rast do ta përcaktojnë kanalin më të përshtatshëm.

15. Punëdhënësit duhet të inkurajohen që t'i kenë procedurat e raportimit të brendshëm.
16. Nëse është e përshtatshme, punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre duhet që të konsultohen lidhur me propozimet për krijimin e procedurave të raportimit brendshëm.
17. Si rregull e përgjithshme, duhet të inkurajohet raportimi i brendshëm dhe raportimi tek organet përkatëse rregullatore publike, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe tek organet mbikëqyrëse.

V. Fshehtësia

18. Sinjalizuesit duhet të kenë të drejtën që ta ruajnë fshehtësinë e identitetit të tyre, duke iu nënshtruar garancive të gjyqimit të drejtë.

VI. Trajtimi i raportimit dhe shpalosjes së informacionit

19. Raportet dhe shpalosjet e informacionit me interes publik nga sinjalizuesit duhet të hetohen menjëherë dhe, kur është e nevojshme, rezultatet të trajtohen nga punëdhënësi dhe organi i përkatës publik rregullator, agjencia e zbatimit të ligjit ose organi mbikëqyrës në një mënyrë efikase dhe efektive.
20. Një sinjalizues i cili e bënë një raport të brendshëm, si rregull i përgjithshëm, duhet të informohet, nga personi tek i cili është bërë raporti, lidhur me veprimet që janë ndërmarr lidhur me raportin.



Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

VII. Mbrojtja kundër hakmarrjes

21. Sinjalizuesit duhet të mbrohen nga hakmarrja e çdo forme, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, nga punëdhënësi i tyre dhe nga personat që punojnë ose veprojnë në emër të punëdhënësit. Format e një hakmarrjeje të tillë mund të përfshijnë shkarkimin, pezullimin, uljen në detyrë, humbjen e mundësive për promovim, transferimet ndëshkuese dhe uljen ose zbritjen e pagës, shqetësimin ose trajtimin tjetër ndëshkues ose diskriminues.
22. Mbrojtja nuk duhet të humbet vetëm në bazë të faktit se individ i cili e bën raportin ose shpalosjen publike ka gabuar në lidhje me raportimin e tij ose se kërcënimi i perceptuar ndaj interesit publik nuk është materializuar, me kusht që ai ose ajo të ketë pasur arsye të bazuar për të besuar në saktësinë e tij.
23. Një sinjalizues duhet të ketë të drejtë që në procedurat e dhura civile, penale ose administrative, ta paraqes faktin që raportimi ose shpalosja është bërë në përputhje me kornizën kombëtare.
24. Kur një punëdhënës e ka krijuar një sistem të brendshëm të raportimit, dhe sinjalizuesi e ka bërë një zbulim për publikun pa iu drejtuar sistemit, kjo mund të merret parasysh kur vendoset për mjetet juridike ose për nivelin e mbrojtjes që do t'i sigurohet sinjalizuesit.
25. Në procedurat ligjore që kanë të bëjnë me një dëm të pësuar nga një sinjalizues dhe në të cilin ai ose ajo ofron arsye bindëse për të besuar se dëmi ka qenë i ndërlidhur me bërjen e raportit ose të shpalosjes së informacionit, punëdhënësi duhet që ta vërtetojë se dëmi nuk ka qenë i motivuar për atë arsye.
26. Lehtësimi i përkohshëm në pritje të përfundimit të procedurave civile duhet të jetë i disponueshëm për personat që kanë qenë viktimë të hakmarrjes për shkak të bërjes së një raporti ose zbulimi me interes publik, veçanërisht në rastet e humbjes së punës.

VIII. Këshilla, ndërgjegjësimi dhe vlerësimi

27. Duhet që të promovohet gjerësisht korniza kombëtare në mënyrë që të krijohet një qasje pozitive në mesin e publikut dhe profesionëve dhe ta lehtësojë zbulimin e informacionit në rastet kur interesi publik është në rrezik.
28. Vëmendje duhet kushtuar qasjes në informacion dhe këshillave konfidenciale pa pagesë për individët që mendojnë që ta bëjnë një raport apo shpalosje të informacionit me interes publik. Duhet identifikuar strukturat ekzistuese që janë në gjendje që të ofrojnë informacione dhe këshilla të tilla dhe të dhënat e tyre të vihen në dispozicion të publikut të gjerë. Nëse është e nevojshme, dhe aty ku është e mundur, mund të pajisen strukturat e tjera të përshtatshme ose strukturat e reja.
29. Autoritetet kombëtare duhet që të ndërmarrin vlerësime periodike të efektivitetit të kornizës kombëtare.

Shtojca 3: Të drejtat e fjalës së lirë në Direktivën e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Sinjalizuesve

Direktiva e Bashkimit Evropian për Sinjalizuesit e muajit Dhjetor 2019 e prezantoi një epokë të re të praktikës më të mirë të të drejtave të fjalës së lirë për kontinentin dhe po e shtrin hapin për lirinë e shprehjes në nivel global. Indeksi i mëposhtëm i përmbledh avantazhet në dispozitat kryesore, me referenca sipas nevojës në përshkrimin i cili siguron më shumë detaje për interpretimin e një gjuhe më të përgjithësuar.

Kush është i mbrojtur? Direktiva ndihmon më shumë njerëz dhe institucione sesa shumica e ligjeve ose politikave të mëparshme të sinjalizuesve. Përveç punonjësve, ajo i mbron sindikatat, organizatat e shoqërisë civile ose personat që ndihmojnë ose që kanë të bëjnë me to, kompanitë ku ata punojnë, aksionarët, furnizuesit, konsulentët dhe të vetëpunësuarit. Direktiva i mbron ata që kanë lidhje ose i ndihmojnë sinjalizuesit. Edhe pse direktiva e inkurajon përdorimin e kanaleve zyrtare institucionale, nuk ka kufizime të bazuara në këtë kontekst. (Nenet 4, 19) Pjesa përshkruese, në paragrafin 62, sqaron se fjala e lirë mbrohet kur komunikohet si pjesë e përgjegjësive të punës: "Kjo Direktivë gjithashtu duhet të siguroj mbrojtje kur ligji i Unionit ose ai kombëtar kërkon që personat raportues të raportojnë tek autoritetet kompetente kombëtare, për shembull si pjesë e detyrave dhe përgjegjësive të tyre të punës ose për shkak se shkelja është vepër penale."

Asnjë boshllëk nuk e ndalon secilin ngacmim në vendin e punës: Me përjashtim të veprimeve të sigurisë kombëtare, që kryesisht janë jashtë autoritetit të BE -së, Direktiva nxjerr jashtë ligjit çdo veprim ose mosveprim i cili shkakton dëm, të drejtpërdrejtë, jo të drejtpërdrejtë, të kërcënuar, ndërmarrë, të rekomanduar apo edhe të toleruar (i cili miraton parimin e detyrës së menaxhmentit për parandalimin e hakmarrjes). (Neni 19)

Mburojë kundër përgjegjësive civile dhe asaj penale: Direktiva e siguron një mbrojtje afirmative e cila e mposht përgjegjësinë penale ose civile kur sinjalizuesi ka "arsye të bazuar për të besuar se raportimi ose shpалosja publike e informacionit ishte e nevojshëm për zbulimin e një shkelje të kësaj direktive". Përjashtimi i vetëm është atëherë kur sjellja e keqe kriminale është e pavarur nga shpалosja e sinjalizimit, siç është thyerja dhe hyrja në ambientet e një organizate. [Nenet 21 (2-3), 21 (7)]

Standard për fjalën e mbrojtur: Për ta fituar të drejtën e mbrojtjes, sinjalizuesit kanë nevojë vetëm për një besim të arsyeshëm se zbulimet e tyre janë të vërteta dhe të rëndësishme. Shumë ligje të tjera kërkojnë që ata ta kenë një besim të arsyeshëm se keqbërësi i dyshuar ishte në të vërtetë fajtor, jo vetëm se ata në mënyrë të arsyeshme besojnë se po raportojnë dëshmi të thjeshta të sjelljes së keqe. Standardi më realist i Direktivës së BE -së u siguron atyre një përparësi të rëndësishme. [Neni 6.1 (a)]

Sekuena e detyrueshëm e raportimit të kanalizuar: Para se ta bëjnë një shpалosje publike, sinjalizuesit duhet që të raportojnë ose brenda institucionit ku ata punojnë ose jashtë tek një autoritet qeveritar. Vonesat për lirinë e shprehjes publike janë tkurrur në tre muaj, sepse sinjalizuesi e ka mundësinë që ta bëjë një shpалosje të jashtme (qeveritare) pa raportuar së pari brenda. Megjithatë, direktiva inkurajon sinjalizuesit së fillimisht të raportojnë brenda organizatës ku ata punojnë, në mënyrë që institucionet ta kenë mundësinë e parë për t'i korrigjuar mangësitë e tyre. (Nenet 7, 10, 15)

Kanalet e brendshme të sinjalizimit: Këto janë kanalet ku punon një sinjalizues, ose ku ka ndodhur sjellja e keqe e supozuar për sinjalizuesit jo-punonjës, siç janë aksionarët ose furnizuesit. Recitali shpjegon se kanalet e brendshme duhet të jenë të lira nga konflikti i interesit, me një personel të trajnuar dhe duhet të udhëhiqen nga një zyrtar i cili i raporton drejtpërdrejt shefit të organizatës. Kjo do ta rrisë legjitimitetin dhe do ta parandalojë mohimin bindës nga ana e udhëheqjes. (Nenet 8, 9)



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Kanalet e jashtme të raportimit: Këto janë kanalet ku një sinjalizues mund të bëjë një raport të mbrojtur tek autoritetet qeveritare kompetente për të hetuar ose urdhëruar veprime korigjuese mbi sjelljen e keqe të supozuar, me kërkesa ekuivalente strukturore sikurse për kanalet e brendshme. (Nenet 11-13)

Veprimi lidhur me zbulimet: Sinjalizuesit kanë të drejtë ta marrin raportin e tyre, ta kenë një takim pasues sipas kërkesës dhe të kenë udhëzime pasuese brenda tre muajve të cilat mund të zgjaten në gjashtë muaj nëse është e nevojshme. (Nenet 8-9, 11-13)

Fshehtësia: Direktiva është e patëmetë dhe ofron mbrojtje nga publikimi i informacionit identifikues pa pëlqimin paraprak dhe kërkon njoftim paraprak në rastet kur ekspozimi nuk është diskrecional. [Nenet 16, 23.1 (d)]

Shpalosjet anonime: Edhe pse veprimi i detyrueshëm pasues është diskrecional, këto marrin kredi si shpalosje informacioni që kualifikohen për mbrojtje nëse identifikohet sinjalizuesi. Kjo e krijon një armë delikate, por shumë të fuqishme, kundër dobësisë së ekspozimit paraprak tek keqbërësit dhe cenueshmërisë ndaj hakmarrjes që janë të qenësishme në nivelin e raportimit. [Neni 6 (3)]

Barra e provës për punonjësin – rasti prima facie: Denoncuesit e përmbushin barrën e tyre dhe ekziston një supozim hakmarrjeje nëse vërtetojnë se janë angazhuar në aktivitete të mbrojtura dhe se më pas kanë pësuar një dëm. Barra e provës pastaj kalon te punëdhënësi. Shumica e ligjeve kërkojnë që sinjalizuesi të dëshmojë gjithashtu një lidhje, ose lidhjen hakmarrëse, midis veprimitarisë së mbrojtur dhe dëmit. Kjo u siguron sinjalizuesve një fillim tjetër të rëndësishëm. [Neni 21 (5)]

Barra e kundërt e provës për punëdhënësin: Nëse punonjësi e krijon rastin prima facie, barra e provës kalon tek punëdhënësi i cili duhet demonstruar se hakmarrja e supozuar nuk ka qenë e bazuar në sinjalizim. Pjesa përshkuese e cila e shpjegon se si të zbatohet ky parim thotë se punëdhënësi duhet të dëshmojë se veprimi i supozuar hakmarrës në një rast "nuk është i lidhur në asnjë mënyrë" me raportin ose shpalosjen e sinjalizimit. [Neni 21.5, Recitali (93)]

Procesi i rregullt: Sinjalizuesit kanë qasje në gjykatë për t'i zbatuar të drejtat e tyre. Përderisa mjetet juridike joformale duhet të jenë të disponueshme për ata që nuk mund ta përballojnë gjyqin, ky është procesi i duhur praktik më i mirë për t'i zbatuar të drejtat. Si rregull, forumet gjyqësore janë më të pavarura nga presioni politik sesa organet administrative. (Neni 21.7)

Kundër ndalesa: Direktiva është e qartë se të drejtat e fjalës së lirë e anulojnë çdo kufizim dhe kërcënim tjetër nga Marrëveshjet e Mos Zbulimit, kontratat, sekretet e pohuara tregtare, ligjet për mbrojtjen e të dhënave, shkeljen e të drejtave të autorit, ose menynë e zgjeruar të proceseve gjyqësore civile dhe penale për shkelje të kontratës ose që sinjalizuesi mori dëshmi përmes vjedhjes së pronës organizative, edhe nëse provat nuk ishin të lidhura me detyrat e punës së sinjalizuesit. Përgjashtimet e vetme janë për veprat e pavarura penale si thyerja dhe hyrja. [Nenet 21 (2-7)]

Përfitimi itë drejtave: Direktiva parasheh ndihmë juridike në procedurat penale dhe civile ndërkufitare. [Neni 20(c)]

Lehtësimi i përkohshëm: Pjesa përshkuese e Direktivës e konsideron këtë një prioritet zbatimi i cili ndërsa i përgjithësuar është parimi më domethënës që ligji ta bëjë ndryshimin.. [Neni 21(6), Pwrshkrimi (93)]

Mjetet efektive juridike: Me mjetet juridike të Direktivës, sinjalizuesit nuk mund të "humbasin duke fituar". Ata kanë të drejtë që të lehtësohen me rikthimin garantuar dhe me kompensimin e dëmit. [Neni 21 (8)]

Llogaridhënia: Direktiva imponon ndëshkime penale, civile ose administrative për ata që angazhohen në hakmarrje ose që i shkelin dispozitat e Direktivës për zbatimin e dispozitave të saj, për mbrojtjen e fshehtësisë ose parandalimin e hakmarrjes. Dënimi për fryrjen e bilbililit është i kufizuar në deklaratat të rreme të bëra me vetëdije, me një ndalim të ndëshkimeve që do të krijonin një efekt ftohës. (Neni 23)



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi

Shtojca 4: Terminologjia

Raportimi në detyrë: komunikimi i informacionit të mbrojtur si pjesë e përgjegjësive të punës.

Barra e provës për punonjësin: kërkesa e provës për punonjësin që ta demonstrojë rastin e hakmarrjes prima facie ose në mënyrë të besueshme ligjërish. Sipas Direktivës së BE -së, kjo do të thotë demonstrim i fjalës së mbrojtur (raport ose shpalosje) dhe veprime pasuese paragjyquese nga punëdhënësi. Punonjësi nuk e ka barrën për ta demonstruar një lidhje midis shpalosjes dhe veprimit të punëdhënësit - vetëm se punonjësi ka bërë një zbulim dhe se ka ndodhur një veprim paragjyqes.

Barra e kundërt e provës për punëdhënësin: dëshmitë të cilat një punëdhënës duhet t'i paraqesë për tu mbrojtur me sukses kundër një pretendimi për hakmarrje pasi sinjalizuesi ta ketë përmbushur barrën e tij/saj të provës. Sipas Direktivës së BE -së, kjo kërkon që të vërtetohet se sinjalizimi nuk ka qenë i lidhur në asnjë mënyrë me veprimin e pretenduar hakmarrës.

Zyrtari i caktuar/personi i autorizuar: Individu përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e shpalosjeve sinjalizuese përmes kanalit të brendshëm të punëdhënësit.

Shpalosja ose raportimi i jashtëm: Sinjalizimi në një zyrë qeveritare e cila ka përgjegjësi për të hetuar ose për të vepruar lidhur me sjelljen e keqe të supozuar.

Shpalosja ose raportimi i brendshëm: Sinjalizimi tek një zyrtar i caktuar në institucionin ku punonjësi është i punësuar.

Shpalosja ose raportimi publik: Sinjalizimi tek një audiencë joqeveritare, siç janë organizatat qytetare, sindikatat ose media.

Besimi i arsyeshëm: Standardi sipas të cilit personi i cili e bënë një shpalosje ose raport është i mbrojtur nga ligji për sinjalizuesit. Sipas praktikave më të mira, kjo do të thotë që sinjalizuesi e beson vërtetë vërtetësinë e shqetësimeve që do të ishin të besueshme për bashkëmoshatarët e tij/saj. Mbrojtja nuk humbet për zbulime të pasakta të bëra në gabime të sinqerta.

Lehtësimi: Sistemi për eliminimin e pasojave direkte ose indirekte të hakmarrjes.

Kompensimi: Kompensimi specifik i urdhëruar si lehtësim në përgjigje të hakmarrjes.

Hakmarrje: Veprimet paragjyquese që ka rrezik ose që ndërmerren kundër një individ nga një punëdhënës kur një individ perceptohet si raportues ose që është gati të raportojë, ose që ka lidhje me një individ i cili raporton paligjshmëri të dyshuara, raste të korrupsionit ose sjellje të tjera të gabuara apo veprime të cilat e kërcënojnë interesin publik siç specifikohet në Direktivën e BE-së.


Sinjalizues: Një individ i cenuar nga një institucion, dhe më së shpeshti një punonjës, i cili komunikon informacione, dëshmi ose shqetësime të mbështetura në një besim të arsyeshëm lidhur me paligjshmërinë, korrupsionin ose sjelljet tjera të gabuara ose veprimet të cilat e kërcënojnë interesin publik siç përcaktohet në Direktivën e BE-së.



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Thyerja e Heshtjes:

Fuqizimi i politikave dhe i kulturës së
sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi



Sekretariati Rajonal i Iniciativës Kundër Korrupsionit (RAI) është një organizatë rajonale ndërqeveritare e fokusuar ekskluzivisht në çështjet e anti-korrupsionit, e cila me angazhimin dhe profesionalizmin e saj punon në fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, duke ofruar një platformë të përbashkët për dialog, shkëmbim njohurish dhe praktikat më të mira kundër korrupsionit në Evropën Juglindore.

www.rai-see.org

Së bashku ne jemi në kërkim të zgjidhjeve më të mira.

